

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fitili që mund të ndezë luftën, Tajvani përplas SHBA dhe Kinën, ja pse është i rëndësishëm
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/fitili-qe-mund-te-ndeze-luften-tajvani-perplas-shba-dhe-kinen-j-i1185863
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 16:34:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 16:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ec1c75fa96403fe10082e0905f5d0ef4eed26af6b1fabe882184489f043ca45
TEKSTI	8b9eaf09db0ae41c62f2204afe3ea6f2def66d2c92386f72e2cb07d900fdfadf
PAMJA	e442b4dc78e8926b65f018c2bc592a2850325066dea3ee828e0d5b7281f489ec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b6d9e073d675746f773a0fea6f6473df1782f83fd7c6c140132a1332616bdbbe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b6d9e073d675746f773a0fea6f6473df1782f83fd7c6c140132a1332616bdbbe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fitili që mund të ndezë luftën, Tajvani përplas SHBA dhe Kinën, ja pse është i rëndësishëm

Nga Rosalba Bejdo
25 Shtator 2026, 18:28 | Bota



Për Pekinin, Tajvani është pjesë e pandashme e territorit kinez dhe ribashkimi me ishullin mbetet një objektiv historik që, sipas autoriteteve kineze, duhet të realizohet një ditë. Për Tajvanin, realiteti është krejt tjetër: ishulli ka qeverinë e vet, ushtrinë, pasaportën, monedhën dhe zhvillon zgjedhje demokratike, ndërsa në praktikë funksionon si një shtet i pavarur, edhe pse nuk njihet zyrtarisht si i tillë nga shumica e vendeve të botës.

Por, për të kuptuar se si u krijua kjo situatë e pazakontë, duhet të kthehemi pas në kohë, në luftën civile kineze dhe në vitin 1949.

"Pse Kina mendon se Tajvani është pjesë e Kinës? Kjo lidhet me luftën civile të vitit 1949 mes Kinës dhe Tajvanit. Në atë kohë, udhëheqësi i Partisë Komuniste Kineze, Mao Ce Duni, dhe forcat e tij mposhtën Kuomintangun, të drejtuar nga Chiang Kai-shek. Chiang Kai-shek, së bashku me ushtrinë e tij dhe një numër të madh familjesh ushtarake, u tërhoqën në Tajvan. Që prej asaj kohe, Partia Komuniste Kineze ka pretenduar vazhdimisht se Tajvani është pjesë e Kinës dhe se rikthimi i tij nën kontrollin e Kinës është një mision i pambyllur," tha Chun-Yi Lee.

Për më shumë se dy dekada pas vitit 1949, përfaqësimi i Kinës në Kombet e Bashkuara ishte një tjetër front i përplasjes mes Pekinit dhe Tajvanit. Republika e Kinës, qeveria që ishte vendosur në Tajvan, vazhdonte të pretendonte se përfaqësonte Kinën, ndërsa Republika Popullore e Kinës kërkonte të merrte vendin e saj në organizatën ndërkombëtare. Në vitin 1971, kjo situatë ndryshoi rrënjësisht. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 2758, duke i dhënë Republikës Popullore të Kinës përfaqësimin e Kinës në OKB. Delegacioni i Tajvanit u largua nga salla.

"Që nga viti 1949 deri në vitin 1971, në Kombet e Bashkuara ekzistonin, në njëfarë mënyre, dy Kina. Në atë kohë, udhëheqësi i Kuomintangut, Chiang Kai-shek, përfaqësonte Republikën e Kinës në Tajvan. Por në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, presidentët amerikanë dhe opinioni publik në SHBA nisën të mendonin se Kina kontinentale duhej të përfshihej në Kombet e Bashkuara dhe se Republika Popullore e Kinës duhej të kishte një vend në organizatë. Chiang Kai-shek e konsideroi këtë si një tradhti ndaj Tajvanit dhe, për këtë arsye, delegacioni i tij u largua nga Kombet e Bashkuara."

Sot, Tajvani nuk është anëtar i OKB-së dhe vetëm një numër i kufizuar shtetesh mbajnë marrëdhënie diplomatike zyrtare me Taipei. Mes tyre është edhe Vatikani. Ndërkohë, shumë vende perëndimore, përfshirë Shtetet e Bashkuara, nuk e njohin Tajvanin si shtet të pavarur në kuptimin diplomatik formal, por mbajnë me të marrëdhënie të gjera dhe të strukturuar jozyrtare. Kjo krijon një nga paradokset më të mëdha të sistemit ndërkombëtar: Tajvani funksionon si një shtet në praktikë, por statusi i tij ndërkombëtar mbetet i kontestuar.

"Statusi i Tajvanit, në këndvështrimin e tajvanezëve dhe në atë ndërkombëtar, është

TE FUNDIT

Sandër Simoni zgjidhet anëtar i KLGJ-së

Pamjet e ekzekutimit të Artan Murtajt, 44-vjeçari largohet me vrap, por nuk arrin të shpëtojë

Ish-aleatja e Trump-it: Na ka tradhtuar. MAGA ka vdekur

"Pula histerike", Rama nga SHBA: Nuk më ndalin dot me baltë e vezë

MË TË VIZITUARAT

Rama nga SHBA: Shqipëria i përket Zotit dhe miqve

Rama: Sot shqiptarët protestojnë për biodiversitetin, pasi ne trefishuam zona...

Rama: E quajti George Washington-in e Kosovës, por Joe Biden e tradhtoi Hashi...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

shumë i ndryshëm. Për tajvanezët nuk ka arsye që Tajvani të mos konsiderohet një shtet, sepse ka pasaportën e vet, qeverinë e vet dhe është një demokraci. Që nga viti 1996, Tajvani ka zhvilluar zgjedhje të rregullta demokratike presidenciale dhe parlamentare. Ka gjithashtu forcat e veta ushtarake. Prandaj, tajvanezët e konsiderojnë Tajvanin një shtet de facto. Arsyeja pse përdor termin 'shtet de facto' është se, në shoqërinë ndërkombëtare dhe në organizata si Kombet e Bashkuara, Tajvani nuk është anëtar dhe nuk konsiderohet shtet në të njëjtin kuptim formal.", tha tha Chun-Yi Lee.

Në këtë ekuacion hyjnë Shtetet e Bashkuara. Uashingtoni i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike zyrtare me Taipei në vitin 1979 dhe njohu qeverinë e Pekinit, por marrëdhëniet amerikano-tajvaneze nuk u ndërprejnë. Ato u riorganizuan mbi bazën e Taiwan Relations Act, që i jep SHBA-së bazën ligjore për t'i siguruar Tajvanit mjete për vetëmbrojtje.

Por ekziston një pikë thelbësore: SHBA-ja nuk ka një traktat të mbrojtjes së ndërsjellë me Tajvanin dhe nuk ka deklaruar zyrtarisht se do të dërgonte automatikisht trupa në rast të një sulmi kinez. Kjo është ajo që njihet si "strategji e paqartësisë" – një politikë që synon të mos e bëjë plotësisht të qartë se si do të reagojë Uashingtoni në rast të një pushtimi.

"Ne gjithmonë flasin për një paqartësi strategjike në marrëdhëniet e SHBA-së me Tajvanin. Nuk është e qartë nëse Shtetet e Bashkuara do të dërgonin trupa për të mbrojtur Tajvanin. SHBA-ja nuk e ka thënë kurrë qartë këtë. Asnjë president nuk ka deklaruar zyrtarisht se do të dërgonte trupa për të mbrojtur Tajvanin.", tha tha Chun-Yi Lee

Megjithatë, Uashingtoni vazhdon t'i shesë armë Tajvanit, ndërsa ushtria tajvaneze stërvitet dhe pajiset me sisteme amerikane, përfshirë tanket M1A2T Abrams.

"Arsyeja pse SHBA-ja vazhdon t'i shesë armë Tajvanit është e rëndësishme për t'u theksuar: Tajvani i blen ato, nuk ia japin falas. Shtetet e Bashkuara vazhdojnë t'i shesin pajisje ushtarake, edhe pse jo gjithmonë sistemet më të avancuara, sepse duan që Tajvani të ketë një sistem mbrojtjeje asimetrike, në mënyrë që të mund të rezistojë nëse, edhe pse askush nuk dëshiron ta shohë këtë, Kina do të ndërmerre një pushtim të Tajvanit.", tha Chun-Yi Lee.

Pekini e kundërshton kategorikisht këtë interpretim. Qeveria kineze e konsideron Tajvanin pjesë të territorit të saj dhe thotë se ribashkimi është i pashmangshëm.

"Tajvani nuk ka qenë kurrë shtet. Deklarata të tilla zbulojnë vetëm arrogancën dhe padijen e disa personave dhe janë provokime të hapura për pavarësinë e Tajvanit. Në botë ekziston vetëm një Kinë dhe Tajvani është pjesë e pandashme e territorit kinez. Qeveria e Republikës Popullore të Kinës është qeveria e vetme legjitime që përfaqëson të gjithë Kinën. E ardhmja e Tajvanit mund të vendoset vetëm nga më shumë se 1.4 miliardë kinezë, përfshirë bashkatdhetarët tanë tajvanezë. Kina do dhe duhet të ribashkohet përfundimisht, dhe ky është një trend historik që asnjë forcë nuk mund ta ndalë.", tha Mao Ning, zëdhënëse e ministrisë së jashtme kineze.

Pekini ka deklaruar se preferon një ribashkim paqësor, por nuk ka hequr dorë nga mundësia e përdorimit të forcës. Në vitin 2005, Kina miratoi edhe Ligjin Kundër Shkëputjes, i cili krijon bazën ligjore për përdorimin e forcës në rrethana të caktuara, ndërsa vetë ligji nuk përcakton në mënyrë të detajuar se si do të veprohet.

Në teori, pyetja duket e thjeshtë. Në praktikë, është shumë më e komplikuar.

Tajvani tashmë ka një qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, territor të kontrolluar prej saj, ushtri, monedhë dhe pasaportë. Por shpallja formale e një "Republike të Tajvanit" do të kërkonte ndryshime kushtetuese dhe një proces politik shumë më të ndërlikuar sesa një deklaratë presidenciale.

Përtej historisë dhe ushtrive, ekziston një tjetër arsye pse Tajvani është bërë kaq strategjik për ekonominë botërore: mikroçipat.

Tajvani është një nga qendrat më të rëndësishme globale të prodhimit të gjysmëpërçuesve dhe kompania TSMC është në qendër të kësaj industrie. Pandemia e COVID-19 dhe tensionet SHBA-Kinë e bënë edhe më të dukshme varësinë globale nga zinxhirët e furnizimit të lidhur me Tajvanin.

"Gjysmëpërçuesit kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishëm në tregtinë mes Tajvanit dhe Shteteve të Bashkuara, jo vetëm për investimet, por edhe për talentin njerëzor. Prodhimi tajvanez i çipave përbën rreth 70 për qind të tregut global të çipave dhe rreth 90 për qind të tregut të çipave të avancuar.", tha Chun-Yi Lee

Presidenti Donald Trump ka kërkuar që një pjesë më e madhe e prodhimit të çipave të rikthehet në Shtetet e Bashkuara, duke argumentuar se industria amerikane ka humbur terren.

Dhe kështu, çështja e Tajvanit nuk është më vetëm një mosmarrëveshje mes Pekinit dhe Taipei. Ajo është një nyje ku takohen siguria globale, teknologjia, tregtia dhe rivaliteti mes dy superfuqive.

Nëse Kina do të ndërmernte një veprim ushtarak kundër Tajvanit, pasojat nuk do të kufizoheshin vetëm në ngushticën që ndan ishullin nga kontinenti. Aty do të përplaseshin interesat e Kinës dhe Shteteve të Bashkuara, zinxhirët globalë të furnizimit dhe një industri nga e cila varet një pjesë e madhe e ekonomisë moderne.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“Po humbasim njerëzillëkun nga AI”,
Paralajmërimi i fortë i Papës: Makineritë
do të marrin kontrollin e tokës



“Rusia po gatuan diçka të madhe!”
Alarmi i Polonisë: Nuk përjashtojmë një
sulm të inskenuar



Dolli dhe një shqiponjë dhuratë, Trump
shtron banket për liderin kinez: Fuqi me
përgjegjësi



Brukseli "presion" Shqipërisë: Kujdes me
planet për gazin amerikan në Ballkan



Sulm kibernetik ndaj FBI-së, publikohen të dhëna mjekësore të mijëra agjentëve

Presidenti Lula: Donald Trump dëshiron të "kolonizojë" Brazilin

Latest Videos



"Hormuzi i Europës", Rusia kërkon mbylljen e Koridorit Suwalki, ndikimi që ka dhe roli NATO-s



Kremlini do të godasi Perëndimit? Eksperti: NATO të forcojë armatimet dhe trupat, Rusia kërcënim



Rusia kërcënon edhe Shqipërinë? Eksperti: Jemi vend aktiv i NATO-s, kemi sistem kundradron



Dronët rus, për sulme apo kontrabandë? Eksperti: Europa të përgatitet, Rusia provokon NATO-n

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.